



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

V E N D I M

Nr. 20 datë 25.01.2019

**PËR NDËRPRERJEN E URDHËRIT PËR CAKTIM NË POZICION TË PËRKOHSHËM**

Në Tiranë, sot më datë 21.01.2019, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pasi dëgjoj në seancën plenare të datës 21.01.2019, relacionin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, si dhe mendimet e paraqitura nga Anëtarët e Këshillit në Mbledhje

K O N S T A T O J

Me urdhërin nr. 247 datë 13.11.2018, Prokurori i Përgjithshëm, bazuar në nenin 160/4 të Ligjit nr.96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë“, ka caktuar përkohësisht prokurorin z. Olgert Rumnica, Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, të ushtrojë këtë funksion si prokuror pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.

Drejtuesia e Prokurorisë Berat, me shkresat e saj, datë 21.12.2018 dhe datë 07.01.2019 ka informuar Këshillin e Lartë të Prokurorisë, për ngarkesën në punë të prokurorëve në Prokurorinë e Beratit. Më konkretisht Drejtuesia e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, ka informuar Këshillin se: *“Në organikën e Prokurorisë Berat janë parashikuar të jenë 6 prokurorë, përfshirë drejtuesin e Prokurorisë.... Aktualisht, janë duke e ushtruar detyrën në këtë Prokurori, 3 prokurorë. Prokurori Gentian Habazaj, emërimi i të cilit është në Prokurorinë e Beratit, është caktuar përkohësisht në Prokurorinë e Tiranës, ndërsa prokurori Olgert Rumnici, që gjithashtu e ka emërimin në Prokurorinë e Beratit, është caktuar përkohësisht në Prokurorinë e Shkodrës, ndërsa një tjetër ka dhënë dorëheqjen nga detyra muaj më parë. Mangësitë lidhur me plotësimin e organikës me prokurorë në Prokurorinë e Beratit kanë shkaktuar problematika të theksuara në mbarëvajtjen e aktivitetit normal të Prokurorisë.....”*

Gjithashtu në kërkesën e dytë drejtuar Këshillit Drejtuesia e prokurorisë Berat parashtron se: ... *“Prokurori Olgert Rumnici, duke qenë se është caktuar rishtazi në Prokurorinë e Shkodrës (nëntor 2018), kishte në hetim disa dosje të rëndësishme, kryesisht për veprat penale të “Shpërdorimit të detyrës”, “Falsifikimit të dokumenteve”, “Mashtimit” apo “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarive kriminale... Në procedimin penal nr.833/2015 dhe 214/2016, rregjistruar për veprat penale të “Shpërdorimit të detyrës”, “Falsifikimit të dokumenteve” dhe “Mashtimit”, prokurori Olgert Rumnicat ka paraqitur kërkesë në gjykatë për vendosjen e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive për pasuri të paluajtshme në një masë të konsiderueshme prej 740 hektarë, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata. Në vijim të çështjes, prokurori ka qenë duke hetuar mbi identifikimin e përgjegjësive penale të disa zyrtarëve të qarkut Berat. Duke pasur si objektiv parësor, funksionimin sa më normal dhe efektiv të Prokurorisë, me qëllim vijimin e hetimeve për çështjet e rëndësishme penale, veçanërisht të çështjes penale të trajtuar më lart, do të vlerësoja të nevojshme që prokurorët e caktuar përkohësisht të ktheheshin me qëllim drejtimin e hetimeve për këto çështje”*.

Sipas nenit 160/4 të Ligjit nr.96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Prokurori i Përgjithshëm, në kushtet kur nuk ishte krijuar akoma Këshilli i Lartë i Prokurorisë, për të mundësuar ushtrimin e detyrave dhe funksionimin e institucioneve të drejtësisë mund të vendoste, caktimin në pozicione të përkohshme të magistratëve. Kjo dispozitë ishte kalimtare dhe si e tillë nuk parashikonte afate dhe rregulla.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, tashmë i krijuar, ka për detyrë ndër të tjera të garantojë pavarësinë, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me parashikimet kushtetuese si edhe në përputhje me rregullimet ligjore të parashikuara në pjesën e tretë të Ligjit 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të titulluar “Zhvillimi i karrierës së magistratëve”. Legjislatori është kujdesur që në këtë kre të përcaktojë rregulla shumë strikte për mënyrën se si zhvillohet karriera dhe si përcaktohet statusi profesional i çdo prokurori.

Nga dokumentacioni i marrë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në Prokurorinë e Përgjithshme, konstatohet se numri mesatar i çështjeve për një prokuror në Prokurorinë e Beratit është më i larti, se në çdo Prokurori tjetër të Republikës së Shqipërisë.

Në këto kushte çmohet e domosdoshme ndërprerja e urdhërit nr. 247 datë 13.11.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për caktimin në pozicion të përkohshëm” të z.Olger Rumnica, si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe rikthimi i tij në pozicionin e tij në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat.

Për sa më sipër në mbështetje të nenit 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 164/8, 166/2, 189/1/a të Ligjit 115 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” Këshilli i Lartë i Prokurorisë

### V E N D O S I

1. Të ndërpresë Urdhërin nr.247, datë 13.11.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për caktimin në pozicion të përkohshëm” të z.Olgert Ruminca, si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe ta rikthejë në pozicionin e tij në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat.
2. Të njoftohen me këtë vendim prokurori Olgert Ruminca, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Berat dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

### **KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

  
**KRYETARI**  
**GENT IBRAHIMI**

**ANËTAR**  
**ANTONETA SEVDARI**

**ANËTAR**  
**BUJAR SHESHI**

**ANËTAR**  
**NURIHAN SEITI**

**ANËTAR**  
**ARBEN DOLLAPAJ**

**ANËTAR**  
**GENTJAN OSMANI**

**ANËTAR**  
**SANDËR BECI**

**ZV/KRYETARI**  
**ALFRED BALLA**

**ANËTAR**  
**BESNIK CANI**

**ANËTAR**  
**KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR**  
**TARTAR BAZAJ**